



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.352/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.352/2022 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.352/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Mbeten në fuqi masat disiplinore: “Vërejtje për dosjen personale” e shqiptuar përmes shkresës me numër protokollit 2022/ZDP/64 të datës 10.03.2022 dhe “Vërejtje për dosjen personale” e shqiptuar përmes shkresës me numër protokollit 2022/ZDP/84 të datës 24.03.2022.**
- III. Anulohet masa disiplinore “Vërejtje për dosjen personale” e shqiptuar përmes shkresës me numër protokollit 2022/ZDP/68 të datës 11.03.2022.**
- IV. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil dhe regjistri përkatës masën disiplinore sipas pikës II të këtij vendimi.**
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

Ar sy e t i m

Ankuesi i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës tutje referuar AACK, më datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1979/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masave disiplinore " Vërejtje për dosjen personale" të shqiptuara nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt përmes shkresës me numër protokoll 2022/ZDP/64 të datës 10.03.2022, shkresës me numër protokoll 2022/ZDP/84 të datës 24.03.2022 dhe 2022/ZDP/68 të datës 11.03.2022, me pretendimet që këto vërejtje nuk qëndrojnë në kuptim të fakteve, provave dhe aspektit procedural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 19.04.2022 ka përcjell në Këshill dokumentacionin lidhur çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 797/2022 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje e shqiptuar përmes shkresës me numër protokoll 2022/ZDP/64 të datës 10.03.2022, Vërejtje e shqiptuar përmes shkresës me numër protokoll 2022/ZDP/84 të datës 24.03.2022 dhe Vërejtje e shqiptuar përmes 2022/ZDP/68 të datës 11.03.2022, Emaili i datës 11.03.2022 nga ankuesi për lidhur me vijueshmërinë në punë; Emailin e datës 10.03.2022 nga për ankuesin lidhur me vijueshmërinë në punë; Urdhëresë Administrative 04/2002 e datës 14.10.2020; Vërtetimin e datës 25.02.2022 në emër të ankuesit; Thirrjet telefoni nga telefoni i ankuesit tek Emailin e datës 25.02.2022 nga Emailin e datës 25.02.2022 nga për dhe Emailin e datës 25.02.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 25.02.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 25.02.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 10.03.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 30.10.2020 nga për ankuesin lidhur me orarin fleksibil; Emailin e datës 20.10.2020 nga ankuesi për Emailin e datës 26.11.2021 nga Emailin e datës 02.11.2021 nga Emailin e datës 06.12.2021 dhe 02.12.2021 nga Emailin e datës 07.12.2021 nga Emailin e datës 22.12.2021 nga Emailin e datës 24.12.2021 nga Emailin e datës 24.12.2021 nga Emailin e datës 29.12.2021 nga Emailin e datës 28.12.2021 nga ankuesi për për ankuesin; Emailin e datës 28.12.2021 nga Emailin e datës 28.12.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 22.12.2021 nga Emailin e datës 24.12.2021 nga dhe Emailin e datës 22.12.2021 nga Harta e akteve nënligjore dhe instrumenteve tjera juridike nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës; Shkresë me titull përshkrimi i procesit-nxjerrja e akteve nënligjore të AAC-së; Emailin e datës 03.12.2021, 01.12.2021 nga ankuesi për Emaili i datës 01.12.2021 nga Emailin e datës 14.12.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 07.10.2021, 06.10.2021, 27.09.2021, 20.09.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 06.10.2021, 01.10.2021, 24.09.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 05.08.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 03.08.2021, 30.07.2021 nga për Emailin e datës 02.08.2021, 29.07.2021 nga për Emailin e datës 08.07.2021 nga për Emailin

e datës 18.02.2022 nga ankuesi për Raporti mbi zbatimin e programit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) gjatë vitit 2020; Emailin e datës 10.03.2022 nga Emailin e datës 10.03.2022 nga Emailin e datës 25.01.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 17.01.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 17.01.2022, 13.01.2022 nga për Emailin e datës 10.01.2022 nga Lista mujore e orarit të punës janar 2022; Emailin e datës 09.03.2022 nga Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 19.04.2022; Akt Emërimit e datës 10.01.2012 në emër të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës Drejtor i Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Emailin e datës 28.02.2022 nga për Emailin e datës 28.02.2022 nga për Emailin e datës 28.02.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 25.02.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 25.02.2022 nga për ankuesin; Raporti për prezencë në punës për muajin mars dhe shkurt 2022; Plotësimin e ankesës datë 26.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit me të dhënat si me lartë, është e pjesërisht e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 10.01.2012, është i punësuar në pozitën Drejtor i Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror në Autoritetit e Aviacionit Civil të Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit më datë 10.03.2022, përmes shkresës me numër protokollit 2022/ZDP/64 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje për dosje personale" për shkak se: *i njëjti më datë 25.02.2022 është regjistruar në vendin e punës në orën 08:56 minuta ndërsa nuk është evidentuar në dalje nga vendi i punës... i është kërkuar të jetë prezent në takim për shqyrtim të kërkesës nga ASHNA sipas emailit të pranuar rreth orës 11:14 të datës 25.02.2022, mirëpo nuk i është përgjigjur emailave si dhe nuk është përgjigjur në telefon, dhe me këtë ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren nr.12/2021 lidhur me Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë si dhe Urdhëresën Nr.04/2020 të datës 14.10.2020. Ndërsa më datë 11.03.2022 mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit përmes shkresës me numër protokollit 2022/ZDP/68, ka shqiptuar ndaj të njëjtit masën disiplinore "Vërejtje për dosje personale" për shkak se: Autoriteti i Aviacionit Civil ka arritur vetëm 83.33% të përmbushjes së përgjegjësisë për vitin 2021 nga Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, sepse në kuadrantin e katër të vitit 2021 ka qenë dashur të përfundojë Rregullorja për ndryshimin e Rregulloreve 01/2020 dhe 17/2017 të cilat janë neglizhuar nga pa ndonjë arsye. Serish me datë 24.03.2022 mbikëqyrësi i drejtpërdrejt përmes shkresës me numër protokollit 2022/ZDP/84, ka shqiptuar ndaj të njëjtit masën disiplinore "Vërejtje për dosje personale" për shkak se: nuk ka dhënë arsyetim për vonesa në punë për muajin shkurt.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vërejtjes së datës 10.03.2020, pretendon se më datë 25.02.2022 i është dashur të lëshoj vendin e punës për shkak të nevojës urgjente të vizitohet dentistin dhe se ka shkuar të te njoftoj mbikëqyrësin por i njëjti nuk ka qenë në zyrë. Sa i përket vërejtjes së datës 11.03.2022 ankuesi pretendon që më datë 26 nëntor 2021 është dërguar tek Zyra Ligjore draft Rregullorja e BE-së 2020/469, dhe e njëjta më datë 29.12.2021 është përcjell në Zyrën e Kryeministrit, andaj AAC nuk

ka asnjë dokument lidhur me afatin kohor për dërgimin e draft rregulloreve, rrjedhimisht me këtë veprim nuk është shkaktuar asnjë dëm sepse AAC për dallim nga vitit 2020 në vitin 2021 ka performancë më të mire në aspektin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, kështu që kemi ofruar mbështetje maksimale për këtë proces. Sa i përket vërejtjes së datës 24.03.2022 ankuesi në ankesë pretendon që kjo vërejtje është subjektive sepse nuk jam i vetmi zyrtar që nuk përmbushi orarin e punës prej 8 orësh sepse ka raste kur zyrtarët shpeshherë nuk përmbushin as 7 orë punë, e kjo në muajin shkurt besoj të jetë e saktë, ndërsa kam email zyrtar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt lidhur me orarin e punës fleksibil.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit kundër vërejtjes së datës 10.03.2022, Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së ankuesi më datë 25.02.2022 ka dalë nga vendi i punës rreth orës 11:30, për shkak të nevojës urgjente që të vizitoj dentistin, këtë e dëshmon edhe vërtetimi i lëshuar më datë 25.02.2022 nga Ordinanca Stomatologjike Endodont. Përkitazi me njoftimin e udhëheqësit të tij, ankuesi në ankesë pretendon se ka shkuar në zyrën e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të njoftojë por nuk ka qenë në zyrë, dhe thirrjes së mbikëqyrësit në orën 11:35, nuk ka mundur të përgjigjet për shkak që ka qenë duke e kryer shërbimin tek dentisti. ndërlidhur me këtë pretendim Kolegji ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht nenit 8 paragrafi 4, më të cilin është përcaktuar se: *Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje menaxheri drejtues, dhe rrjedhimisht në kuptim të dispozitave ligjore Kolegji konstaton se ankuesi me asnjë dëshmi nuk ka vërtetuar së i njëjti ka njoftuar mbikëqyrësin e tij për largim nga puna për shkuarje të dentisti dhe sipas vlerësimit të Kolegji një njoftim i tillë ka mundur të behët edhe përmes sms apo emialit, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë se ankuesi nuk ka respektuar nenin 8 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht pretendimi i ankuesit që kjo vërejtje është e qëllimshme dhe tendencioze është i pa bazuar.*

Sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me vërejtjen e datës 24.03.2022 se kjo vërejtje është subjektive sepse posedon email zyrtar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt lidhur me orarin e punës fleksibil, Kolegji nga shqyrtimi i provave materiale ka konstatuar së bazuar në kërkesën e ankuesit të datës 20.10.2020 që për arsye familjare ti mundësohet një orar fleksibil, mbikëqyrësi i tij më datë 30.10.2020 ka aprovuar kërkesën e ankuesit dhe të njëjtin e ka udhëzuar që të konsultohet me Burimet Njerëzore lidhur me këtë orar. Përkitazi me këtë pretendim Kolegji ju referua Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht nenin 4, ku përcaktohet se: *1. Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten... 4 Përveç orarit të rregullt të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, nëpunësit mund të punojnë me orar fleksibil të punës. Orari fleksibil i punës mund të aplikohet vetëm nëse sigurohet numri i nevojshëm i orëve të punës dhe mund të filloj deri në një orë me vonesë se sa orari i rregullt i punës. Për orarin fleksibil të punës njoftohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit..., Po ashtu orari i njëjtë i punës është përcaktuar edhe me Urdhëresën Nr.04/2020 të datës 14.10.2020 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i AACK-së. Andaj, nisur nga kjo bazë ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë rregulluar çështjen e orarit fleksibil të punës me Njësinë e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil, e si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton së në bazë të evidencës së hyrje/dalje në punë*

për muajin shkurt 2022 dëshmohet se më datë 01.02.2020, 02.02.2022 03.02.2022 04.02.2022, 07.02.2021, 08.02.2022, 10.02.2022, 11.02.2022, 14.02.2022, 15.02.2022, 21.02.2022, 22.02.2022, 24.02.2022, 25.02.2022 dhe 28.02.2022, ankuesi nuk ka plotësuar numrin e nevojshëm të orëve ditore në punë, kështu që Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka respektuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, rrjedhimisht pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Nisur nga rrethanat si me lartë Kolegji vlerëson se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" të datës 10.03.2022 dhe "Vërejtje" e të datës 24.03.2022, ka konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankuesit si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të lehtë disiplinore siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë si dhe nenin 48 paragrafi 2 të të njëjtit ligj më të cili është përcaktuar se: *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.*

Duke u bazuar në nenin 50 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: *Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore",* dhe meqenëse masat disiplinore të shqiptuara ndaj ankuesit kanë të bëjnë më periudha të ndryshme dhe shkelje të ndryshme, atëherë rezulton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ka vepruar konform dispozitave ligjore të lartcekura, kështu që edhe pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pabazuar.

Sa i përket masës disiplinore vërejtje të datës 11.03.2022, Kolegji në bazë të dëshmive të ofruara nga palët, konkretisht në bazë të emailit të datës 26.11.2021 ka konstatuar se Rregullorja EU 2020/469 është dërguar tek Zyra Ligjore në tri gjuhët zyrtare, mirëpo e njëjta për shkak të gabimeve teknike është rikthyer për përmirësim e cila serish më datë 06.12.2021 është dërguar tek Zyra Ligjore, ku kjo e fundit me datë 07.12.2021 ka kërkuar publikimin e Rregullores në wefaqen e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për konsultim publik nga data 07 deri 22.12.2021, ndërsa më datë 29.12.2021 draft Rregullorja është përcjell në Zyrën e Kryeministrit për miratim, rrjedhimisht nga provat materiale nuk mund të vërtetohet se ankuesi ka neglizhuar punën lidhur me rregulloren në fjalë sepse nga shkresat e lëndës nuk gjinden prova se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt si Zyrtar Kryesor Administrativ të ketë kërkuar me parë veprime lidhur me këtë Rregullore dhe se ankuesi të mos ketë ndërmarr veprime në përmbushje të kësaj përgjegjësi, kështu që bazuar në këto rrethana rezulton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit nuk ka konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankueses, si dhe nuk ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses si shkelje të lehtë disiplinore siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë.

Siç u tha me sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje



Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.352/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar për bashkëpunim profesional/procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

